

DEBATI

Mbi pajtimin dhe potencialin e KOMRA-s që t'i kontribuojë këtij procesi

21.12.2015. Prishtinë

Transkriptim, me përkthim të pjesëmarrësve prej BHS në shqip

Moderator Bekim Blakaj: Mirëdita të gjithëve! Ju lutem, i zëne vendet! Përkthimi i gjuhës shqipe, është kanali 2. Përkthimi në serbisht në kanalin nr. 3, përkthimi në anglisht në kanalin numër 4.

Unë quhem Bekim Blakaj, dhe në emër të koalicionit për KOMRA ju dëshiroj mirëseardhje në këtë debat dhe kam nderin që të moderoj këtë debat i cili është i organizuar nga Koalicioni për KOMRA, në vazhden e debateve të cilat janë organizuar dhe do të organizohen edhe nëpër qendra tjera në shtetet e dala nga ish Jugosllavia.

Realisht, në Shkup, Beograd, Zagreb, Banja-Llukë janë organizuar debate të tilla dhe do të vazhdojnë të organizohen edhe në qendra tjera.

Ky debat është tematik dhe tema në këtë debat, është pajtimi nga këndvështrimi i politikanëve vendorë dhe atyre të BE-së.

Dua të shfrytëzoj rastin, për ta keqpërdorur, të them ashtu, këtë pozitë dhe me ju thënë që ne, respektivisht Koalicioni për KOMRA i ka nxjerrë disa deklaratat të politikanëve gjatë këtij viti dhe vitit të kaluar mbi pajtimin në këtë rajon dhe këtë dokument mund ta merrni para sallës, në tavolinë.

Gjithashtu, shkurtimisht dua të ju them se mund ta merrni edhe përmbledhjen e shkrimeve dhe mendimeve të ndryshme të pjesëtarëve të shoqërisë civile, të intelektualëve, respektivisht të komunitetit akademik dhe të viktimave, që janë mendime të cilat janë nxjerrë gjatë forumit 9 dhe 10 për drejtësitë tranzicionale.

Gjithsesi, nuk dua të ju marr shumë kohë, sepse kemi panelistë të nderuar prezantimet e të cilëve do të jenë jashtëzakonisht interesante. Gjatë këtij debati ne do t'i trajtojmë pyetjet se çka paraqet procesi i pajtimit në rajon, cili do të ishte apo është kontributi i politikanëve vendorë në këtë proces, cili është roli i Bashkimit Evropian në procesin e pajtimit në rajon dhe çfarë është dhe si do të duhej të dukej procesi i pajtimit. Po ashtu një ndër çështjet është se si duhet të shfrytëzohet trashëgimia e gjykatës penale ndërkombëtare për ish Jugosllavi dhe a ka potencial shoqëria civile për trasimin e themeleve të procesit të pajtimit, dhe gjithashtu në këtë aspekt a mund të ndihmojë KOMRA në zgjedhjen e disa problemeve rreth procesit të pajtimit dhe cili është potenciali i KOMRA-s.

Kam nderin që të jam nikoqir i panelistëve të nderuar profesor Zharko Puhoski i cili ka udhëtuar nga Zagrebi, profesor Enver Hoxhaj, zotëri Petar Miletij, zotëri Azem Vllasi dhe zotëri Arifaj. Unë, në fillim do t'ia kisha dhënë fjalën profesorit të nderuar Zharko Puhovski. Urdhëroni!

Žarko Puhovski: Duke kërkuar falje që do flas në gjuhën kroate, e jo në gjuhën e gjyshit tim Shqiptarë i cili ka vdekur shumë i ri dhe nuk kam pasur rast të mësoj nga ai, dua t'i them disa teza hyrëse.

Së pari, ajo që në parim kupton dhe mundet të kuptojë pajtimin, është vetëdija mbi a) lufta ka përfunduar, b) që ekziston njohuri e mjaftueshme se çka ka prurë lufta, ajo e keqe e zakonshme, sigurisht, ka ndonjëherë edhe diçka të mirë për palën e cila ka fituar, dhe c) se si shpërndahet përgjegjësia për luftë, e cila zakonisht është pika pengues.

Thjeshtë, kërroj çka dimë nga historia tregon se nuk ekziston përgjegjësia 100 ndaj 0. Mund të jetë 95 ndaj 5 ose 50 ndaj 50. 100 ndaj 0 në marrëdhëniet në mes të njerëzve nuk ekziston, sikurse edhe në divorc të martesës ashtu edhe në luftë, 100 ndaj 0 nuk ekziston si përgjegjësi. Pra, nuk ekziston gjendje, përveç konstruktimit të paramenduar, në të cilën njëra palë është fajtores dhe vetëm fajtores dhe pala tjetër e drejtë dhe vetëm e drejtë. Dhe kjo është çka duhet pasur gjithmonë në mendje.

Nga kjo, nëse merren parasysh këto tri pika, pason ajo që në traditën krishtere, e cila në këtë fushë ka bërë më së shumti, nga Dhjata e Re, nga termini i cili është huazuar, rekonsilimi apo reconciliation në anglisht d.m.th. që prapë të takohen, prapë të jenë bashkë.

Pra, pika e parë e cila pason është që pas luftës prapë të ketë komunikim. Në kohët e lashta sigurisht të jesh bashkë ka qenë mënyra e vetëm e komunikimit, sot mundet edhe ndryshe. Pra, vendosja e komunikimit.

Të shtoj këtu, që për mendimin tim më së shpeshti ka qenë gabim, është insistimi nga jashtë nga një numër i politikanëve, diplomatëve, gazetarëve, spiunëve e kështu me radhë, të cilët kanë ardhur, dhe menjëherë janë gjuajtur në pajtim, e cila do të shënohej si një lloj i dashurisë së porsalindur. Çka ka ndodhë ka ndodhë, t'ia zgjasim dorën njëri tjetrit, dhe shkojmë tutje. Dhe kjo gjithmonë ka japë efekte negative.

Ajo që është në mes të luftës dhe pajtimit është normalizim i mundimshëm i përditshëm dhe gradual. Nëse në fillim nuk mundemi të jetojmë me tjerët, atëherë së pari duhet të jemi në gjendje të jetojmë afër njëri tjetrit, dhe mos të vrasim njëri tjetrin. Pastaj, hap pas hapi. E kjo do të thotë se një ditë një i ri Kroat të shpëtojë një fëmijë Serb i cili ka rënë në një gropë, ditën tjetër një profesor Shqiptarë të mësojë një fëmijë Serb të luajë në violinë, e kështu me radhë, dhe atëherë shihet se nuk janë të gjithë ata të njëjtë.

Duke marrë parasysh se luftërat veprojnë në homogjenizimin e bashkësive etnike, pajtimi do kishte në vete dy elemente kontradiktore, në njërin anë de-homogjenizimin, pra ndër-gjegjësimin që nuk janë të gjithë ata të njëjtë dhe nga ana tjetër prapë homogjenizimin në emër të asaj që tani takohen bashkësitë etnike që kanë qenë në luftë ndërsa tani nuk janë dhe e dinë që nuk janë më në luftë.

Këtu prapë ekziston një lloj i rrugës së shkurtër me rezultat të dyshimtë e cila është treguar në Evropën Perëndimore viteve të pesëdhjeta. Pas suksesit të madh të mrekullisë ekonomike Gjermane, u duk që gjenerata e re Gjermane në fund të viteve pesëdhjeta dhe në fillim të viteve

të gjashtëdhjeta tha se çka ka ndodhur ka ndodhur, shkojmë tutje. Dhe pastaj atje u lajmërua gjenerata ime, e gjashtëdhjetave, gjenerata e atyre që më 1968 ka protestuar, e cila i ballafaqoi prindërit me të kaluarën. Sepse, për arsye emocionale mund të gënjeni policinë, mund të gënjeni gazetarët, mund të gënjeni gjykatësit. Të gënjeni fëmijët tuaj është shumë e vështirë.

Formula e 68-tës ka qenë që të kuptohej njohuria e një filmi amerikan jo posaçërisht të mirë, “çka ke bërë në luftë baba?”. Dhe këtu është shansi që diçka në të vërtetë të ndodhë. Sigurisht, struktura patriarkale e familjes në hapësirat tona këtë e vështirëson, por kjo është një mënyrë e mikro qasjes ndaj pajtimit nga brenda, e cila fillon me pastrimin, respektivisht... formulimin e përballjes me të kaluarën. Kur më të mos kemi thjesht dy rrufe nacionale, ku njëra është kundër tjetrës, por kemi shumë individ, dhe atëherë do ketë debat në lidhje me atë se si e përcaktojmë cila është e vërteta.

Të mos flas shumë si profesor i filozofisë, për një moment më duhet. I kemi dy koncepte të së vërtetës. Një nga filozofi i madh gjerman Hejgeli, i cili thotë – e vërteta është tërësia. I dyti, 150 vite më vonë, filozofi gjermano çifut Adorni, i cili thotë tërësia është jo e vërteta. Çka do të thotë kjo në shembujt tanë, në situatën tonë të dytë? Ta marrim një shembull të thjeshtë, le të themi nga Gjermania, që të jemi neutral. Në vjeshtën e vitit 1944 dhe pranverën e vitit 1945 armata e kuqe ka dhunuar në mes të 800.000 dhe 1.200.000 gjermane, përderisa lëvizte në drejtim të Berlinit. Kush është përgjegjës për këtë? Natyrisht, Hitleri ka nisur luftën, por nuk është që Stalini dhe komandantët e njësisve Sovjetike, duke përfshirë oficerët e gradave më të ulëta e deri më të larta, nuk kanë pas njëfarë faji dhe përgjegjësie. Tërësia është e vërteta, Hitleri është fajtor. Tërësia është jo e vërteta për një grua të cilën e kanë dhunuar në Potsdam, ku konkretisht është përgjegjës ndonjë tetar i ndonjë njësie e cila ka qenë atje dhe ka thënë, djem ejani që të relaksohemi pak.

Dhe kjo neve na paraqitet si problem. Ne kemi pak a shumë, dhe kjo në disa pjesë të ish Jugosllavisë nuk është e lehtë që të pranohet, vetëdijen se lufta ka filluar nga Beogradi. Sipas mendimit tim ka filluar si sulm i Jugosllavisë në pjesët e saja, dhe dikush tjetër do thotë se ishte sulm i Serbisë, për këtë mundemi të debatojmë, por ka filluar nga Beogradi. Por kjo nuk do thotë se në çdo situatë konkrete krejt ka të bëjë me Millosheviqin, Kadijeviqin dhe Axhiqin, apo si janë quajtur, edhe pse një pjesë e madhe ka të bëjë me ta.

Dhe kjo është ajo për të cilën pajtimi paraqitet si problem aq kompleks. Të jesh, pra, në gjendje që të thuash a) e dimë se çka ka ndodhur, b) nuk do e harrojmë këtë, harresa sjell probleme të reja, i c) pa marrë parasysh mbesim fqinj dhe na duhet të kontaktojmë në mënyra të ndryshme, nga ekonomia e tutje.

Dhe kjo ndodh shumë vështirë dhe ngadalë. Kur shikoni situatën sot, shembull në mes të Kroacisë dhe Serbisë, ajo është aq shumë, unë do thosha, e normalizuar në mënyrë të çoroditur. Që kryeministri i Serbisë të kompozojë shumicën qeveritare pas zgjedhjeve në Kroaci, duke ndikuar në deputetët serb se kujt duhet t'i japin përkrahje. Dhe ky është një normalizim më shumë se sa më pëlqen mua, që të them sinqerisht. Por ky është një lloj i normalizimit. Po të thoshte dikush para 10 vitesh, do thoni se nuk ka gjasa.

Në të gjitha shtetet post Jugosllave, nga Sllovenia, le ta marrim, lajmërohet, kur flet privatisht, fjalia e njëjtë – tani më nuk ka Jugosllavi që ta fajësojmë, nuk ka më Serbë që t'i fajësojmë. Të shikojmë se si qëndron puna në mes neve Sllovenëve, në mes neve Kroatëve, në mes neve Kosovarëve.

Tani të shikojmë se si kanë qenë disa brenda, sepse në luftë kemi një bashkim të dhunshëm kundër armikut, dhe të gjitha dallimet politike dhe morale bien në plan të dytë. Kur lufta mbaron, vetëm atëherë disa gjëra shihen mirë.

Është bindje e gabuar dhe e gjerë e përhapur që njerëzit tregohen më së miri me karakteristikat e veta morale gjatë luftës. Të shohim, në shumë raste është treguar se më së miri pasqyrohen në paqe. Njerëzit që janë mbajtur në mënyrë fantastike në luftë nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë në paqe. Sepse në paqe duhen njerëz më ndryshe.

Një ndër problemet në gjendjen e pasluftës është që të kuptohet që ata që ishin më të mirët në luftë, nuk do të thotë se janë më të mirët në paqe, sikurse që këta që janë më të mirët në paqe në përgjithësi nuk janë më të mirët në luftë. Ekziston një përjashtim. Ajzenhauer në Amerikë është një përjashtim, i cili gjithmonë për vete thoshte ju lutem më kuptoni, unë jam përjashtim, gjeneral si president i SHBA-së është përjashtim. Dhje kjo është kështu.

Nuk mundet që çdo gjeneral të jetë kryetar i shtetit dhe as që duhet. Në Kroaci kjo nuk pa pasur sukses. Kemi raste të ndryshme. Por këto nja tregojnë se sa është me rëndësi, pra, që sa zgjat një proces i normalizimit para pajtimit, pra raportet në të cilat jetojmë njëri pranë tjetrit, nëse jo ende njëri me tjetrin. E dyta, është i nevojshëm dehomogjenizimi, pra ndarja e shtresave e bashkësive etnike, jo në atë mënyrë që ato të shkatërrohen por që individët brenda tyre të dinë që vet të vendosin se si do të sillen me dikë në anën e kundërt.

Unë mundem, sic thonë shumë Kroat, të them se nuk dëshiroj të shkoj në Beograd. Dhe kjo është e drejtë e imja. Në Izrael deri në vitin 1990 asnjëherë nuk është luajtur muzika e Vagnerit. Ndërsa Vagneri ka vdekur 70 viteve para se të vije Hitleri në pushtet, por muzika e tij është luajtur në kampet e përqendrimit. Dhe Vagneri nuk është fajtor për këtë. Por ka qenë në Izrael me.... unë nuk kam shumë simpati për këtë, por kam mirëkuptim. Pra, dikush mund të thotë nuk dua. Dikush tjetër do të thotë unë dua. Pra nuk mund të ketë detyrim për të gjithë që i takojnë një populli. Por disa gjeste simbolike duhet të behën, dikush duhet diçka simbolike të bëjë në emër të gjithë kombit. Dhe aty me atë problemin përfundimtar, me pikën e veçantë të cilën na e përmendi parafolësi, pyetje mbi funksionimin e shoqërisë civile.

Ne në shoqërinë civile shumë çka kemi bërë, por sipas definicionit ne nuk mundemi të bëjmë atë më të rëndësishmen. Ne nuk kemi kompetenca që ta përfaqësojmë bashkësitë tona. Të them në nivel të njerëzve që i njoh, duke filluar nga mikja ime Natasha Kandiç, të cilët e respektoj pa masë, krejt çka mund të bëjë Natasha kandiç, kur bëhet fjalë për pajtimin kusht është që Vuçiqi ta nxjerr një gjysmë fjalie e cila ka rëndësi dhjetë herë më të madhe nga gjithë ajo që thotë Natasha Kandiç. Ky është realitet politik.

Dihet se në cilën anë janë simpatitë e mia, nuk ka ... me Vuçiqin. Por ai është i cili mund të thotë diçka në emër të Serbisë, jo Natasha Kandiç.

Natasha Kandiq apo dikush nga kolegët këtu bën dhe to të bën shumëçka që të përgatitë mundësinë për diçka të tillë, të bëjë atë që ... në shoqëri e bën, në fakt ne kontrabandojmë temat nga margjinat në qendër të vëmendjes publike. Ajo është puna jonë, ne jemi kontrabandistë. Ndonjëherë kontrabanda ka sukses, ndonjëherë dogana e rreptë këtë e ndalon. Por kur kemi sukses, atëherë i shtyjme që në publik të fillojnë të flasin për këto tema pak më ndryshe, që të mos shajnë më palën tjetër vetëm pse është palë tjetër.

Dhe atëherë kemi atë normalizim i cili është parakusht për pajtim. Pajtimi ndodh edhe në nivel të kontakteve personale, në të ashtuquajturin nivelin më të ulët, secili prej nesh me definicion është niveli më i ulët, ndërsa niveli më i lartë kur ata i shtrëngojnë duart, puthen apo nuk e di se çka tjetër bëjnë, gjeste tjera simbolike ku tregohen.

Bekim Blakaj: Ju faleminderit shumë profesor Puhovski, si gjithmonë ekspozim i jashtëzakonshëm. Tani e ka fjalën Hoxhaj! Urdhëroni!

Enver Hoxhaj: Faleminderit shumë, Bekim! Faleminderit shumë zoti Blakaj!

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Më lejoni në fillim të shpreh admirimin dhe respektin tim për punën e madhe që Fondi për të Drejtën Humanitare, pothuaj se për dy dekada e ka bërë në raport me Kosovën dhe në raport me rajonin dhe mendoj që zonja Kandiq por edhe zoti Blakaj në Prishtinë dhe Kosovë kanë bërë një punë të shkëlqyeshme dhe ne që jemi në politikë, por ne që arrijmë prej Universitetit në politikë kemi një respekt për këtë punë që ky koalicion por në të njëjtën kohë edhe ky fondacion ka bërë deri më tash.

Për mua është një nder i madh që profesor Puhovski është sot me ne në Prishtinë, ndër mendjet më me ndikim kisha thënë në Ballkanin perëndimor, edhe pse nuk e di a hyn Kroacia në Ballkan perëndimor, ky është një koncept pas vitit 1999 i përhapur, por një intelektual i madh dhe një aktivist për të drejtat e njeriut.

Jam i nderuar që jam në këtë panel edhe me zotin Vllasi, edhe me zotin Miletqi, edhe me zotin Arifaj.

Pajtimi është një çështje e cila është e ndjeshme dhe është një çështje sa politike po aq edhe shoqërore. Është edhe një temë emocionale, edhe njerëzore, është edhe individuale, dhe prej përvojave të mija është edhe një proces individual, por në të njëjtën kohë është edhe një proces kolektiv.

Kur në qershor të 1999 përfundoj lufta e fundit në ish hapësirën jugosllave, disa prej nesh dhe atë botë unë kam qenë më shumë aktiv në shoqëri civile se sa në politikë, mendonim që pas dhjetë vitesh, njëzet vitesh eventualisht do të mund të krijohej një peizazh i ri dhe parakushte tjera politike që popujt e ish Jugosllavisë, ata të cilët e përjetuan luftën për një dekadë do të mund të pajtohen.

Nëse nga viti 2015 e shohim peizazhin e shteteve të reja të Ballkanit, ne shohim që padyshim rajoni ka bërë një progres. Edhe Kosova, dhe vendet tjera kanë bërë një progres por pajtimi i mirëfilltë, për mendimin tim, është edhe i largët. Ndoshta mund të presim edhe dhjetë vite, edhe njëzet vite që të ndodhë.

Gjysma e asaj se çfarë thirret si Ballkan sot është në BE dhe në NATO. Një pjesë tjetër e rajonit, i cili ka mbetur jashtë Bashkimit Evropian dhe NATO-s është në një situatë ku marrëdhëniet në mes të shteteve dhe të popujve kanë përjetuar një përmirësim të mirëfilltë nga marrëdhënia armiqësore ku kemi një raport të marrëdhënies të paqes në mes popujve, nga një rajon i cili ka qenë jostabil kemi një stabilitet më të qëndrueshëm, ka një shkëmbim në mes ekonomive dhe shoqërive, ka takime të rregullta të qeverive qoftë në nivel bilateral, qoftë në nivel multilateral, do të thotë ka një përmirësim të marrëdhënies për një transformim të plotë të marrëdhënies se si ne kemi mund ta presim në qershor të 1999 e deri me tash nuk ka ndodhur. Në këtë drejtim për shkak të këtij procesi të pa përmbyllur, rajoni edhe më tutje është fragjil, i pasigurt dhe për mendimin tim është në një lloj status-quo dhe unë po flas për këtë pjesën politike se ky peizazh politik ndikon padyshim edhe në pajtimin si proces, dhe është e gabuar ne të mendojmë se nëse politika nuk lëvizë përpara pajtimi do të ndodhë.

Nuk dua të flas për atë se si e shoh pajtimin në rajon ose në ish hapësirën jugosllave. Më shumë dua t'i them tri shqetësime të mia personale se si e shoh raportin e Kosovës me Serbinë dhe procesin e pajtimit në mes Kosovës dhe Serbisë.

Së pari pajtimi është një proces politik. Profesor Puhovski e përmendi – Adornon, unë nëse s'gaboju dikur 1994, 1995 para, gjatë dhe pas Srebrenicës e kam lexuar një artikull të Adornos me titull gjermanisht “Was bedoitet fergagenes auf bebeitung”, “Çka nënkupton ballafaqimi me të kaluarën”, është një ligjeratë e tij e vitit 1968. Nuk dua të flas si profesor, por vetëm po e përmendi si një premisë të parë. Dhe në atë artikull Adorno thotë që nëse agjenda e cila i ka sjell popujt në konflikt apo në luftë pas përfundimit të konflikteve dhe të luftës nuk ndryshon, mbetet e njëjta. Atëherë shumë pak ka parakushte që të ndodhë një pajtim i mirëfilltë politik.

Natyrisht se ai ka parasysh raporte evropiane, gjermano-franceze, gjermano-polake. E unë mendoj që një konkluzë e tillë, mos ndryshimi i agjendës, pas fundit të luftës dhe të konfliktit, padyshim se është një premisë e cila neve na mundëson që ta kuptojmë çdo situatë tjetër në botë.

Çfarë do të thotë kjo për Kosovën? Edhe pas luftës së fundit në Kosovë, edhe pas spastrimit etnik, edhe pas krijimeve të regjimeve të ndryshme gjatë një shekulli, nuk është mirë vetëm të mendojmë për atë se çfarë ka ndodhur në 1998 dhe 1999. Ju e dini që në rastin e Kosovës ne kemi të bëjmë me një fenomen i cili ka qenë një armiqësi e planifikuar serbe gjatë një shekulli. Do të thotë është fenomen i një armiqësie të planifikuar ndaj një populli në Kosovë.

Edhe pas gjithë këtyre gjërave të tmerrshme që kanë ndodhur, Serbia nuk e ka ndryshuar qëndrimin në raport me Kosovën. Dhe kur jemi në një debat të tillë, duhet ta themi hapur dhe duhet ta shtrojmë hapur mënyrën se si është.

Nëse deri në qershor të 1999 koncepti i armiqësisë së planifikuar, ka nënkuptuar që qeveritë e ndryshme dhe elitat e ndryshme politike në Beograd kanë pasur një qëndrim armiqësor ndaj

shoqërisë kosovare. Dhe pas shpalljes së pavarësisë në 2008 e deri më sot kemi po ashtu një qëndrim armiqësor ndaj shtetit të Kosovës. E ne duhet ta themi qartë sikur që gjërat janë.

Edhe sot kur ne flasim, në dhjetor të 2015 kemi një Qeveri në Beograd e cila synon që ta minojë shtetësinë e Kosovës brenda përbrenda territorit të saj, dhe e cila synon ta izolojë vendin – shtetin tonë më të ri ndërkombëtarisht.

Rasti i fundit i UNESCO-s, dhe jo vetëm rezultati i UNESCO-s por mbi të gjitha gjuha e cila është përdorur, diskursi i cili është përdorur, që ka qenë diskurs i planifikuar dhe menduar mirë – flet për atë që ka një kontinuitet të mendimit serb mbi Kosovën, mjerisht, të njëjtën këto 20 vite, 30 vite të fundit.

Përtej kësaj Kosova nga viti 2011 është në një dialog për normalizimin e raporteve me Serbinë dhe ky dialog nuk ka pasur për qëllim vetëm që të arrijmë marrëveshje të caktuara. Dialogu ka pasur për qëllim që të ndërtohet edhe një lloj besimi në mes të dy popujve, në mes të dy elitave. Po nëse ne e nxjerrim një bilanc të këtij besimi, në këto pesë vitet e fundit, është një lloj besimi i lënduar.

Ne kemi arritur diku 17 marrëveshje, 4 prej tyre deri më tash kanë mbërritur që të jetësohen. Ky është padyshim fillimi i një procesi dhe jo fundi i një procesi. Do të thotë na pret një rrugë e gjatë, por dialogu për normalizim mund t'i shërbejë pajtimit nëse paraprakisht e kemi një cak të qartë dhe caku i qartë duhet të jetë arritja e njohjes së ndërsjellët diplomatike në mes të dy vendeve.

Nëse ne mendojmë që normalizimi duhet të merret vetëm me çështje teknike, t'i zgjidhë disa probleme gjatë rrugës, por nuk do të përfundojë me njohje të ndërsjellë diplomatike në mes të Kosovës e Serbisë, unë mendoj se nuk kemi parakusht themelor që pajtimi të ndodhë.

Në këtë drejtim, për shkak të një të kaluarë të vështirë, për shkak edhe të një raporti, dialogu nuk është asgjë tjetër veçse një dialog në mes një viktime njëshekullore, si ka qenë shoqëria kosovare dhe të një pushtuesi njëshekullor.

Ky është raporti real i asaj se çka ndodhë në dialog.

Dhe nëse nuk ka vullnet politik që të tejkalohet ky raport tragjik i së kaluarës, unë e shoh problematik në të ardhmen edhe procesin e pajtimit. Ne mund të mblidhemi edhe 10 vite a 15 vitesh... E di që në 2000 kam qenë në një takim në Mal të Zi, në Zhablak së bashku me Natasha Kandiçin, Sonja Biserkon, Ivo Banac dhe shumë të tjerë dhe do me thënë që konkluzat që i kemi nxjerrë në atë kohë vlejné edhe sot, përkundër progresit i cili është evident, por nuk është edhe aq premtues.

Së dyti, pajtimi nuk mund të jetë vetëm një pajtim politik dhe ndërshtetëror, por duhet të jetë edhe në mes dy shoqërive. Nëse ne kemi dialog në mes Kosovës dhe Serbisë i cili është dialog politik, por edhe një dialog teknik, unë jam i mendimit që duhet ta kemi edhe një dialog të tretë, të cilin e kam thënë edhe në vitin e kaluar sepse kam qenë në vizitë në Beograd në nëntor të vitit të kaluar si ministër i Jashtëm, duhet ta kemi një dialog shoqëror, një dialog në mes dy shoqërive, i cili mbështetet prej elitave politike: “Dialogu në mes dy shoqërive duhet të bartet nga ju në

sallë, por në mbështetje të dy qeverive dhe me mbështetje të lidërshipeve politike të dy vendeve”.

Elitat kulturore, shoqëria civile, universitetet, rrjetet e të rinjve, odat ekonomike, komunat e deri te grupet e ndryshme, duhet të kenë një rol në këtë dialog.

Pse është i rëndësishëm ky dialog shoqëror, anglisht i themi më shumë “so saiten” – dialog që në shqip është pak problem të përkthehet në mënyrë precize.

Edhe 15 vite pas luftës në Kosovë ka paragjykime, ka keq perceptime, ka mosbesim dhe mbi të gjitha ka një mungesë të të kuptuarit se çfarë është realisht Kosova dhe çfarë është Serbia. Dhe për mendimin tim, ky dialog në mes të dy shoqërive do të ndikonte fillimisht në të kuptuarit e mirëfilltë të asaj se kush jemi në vitin 2015, kush do të jemi në vitin 2016, do të ndikonte që të ndryshohet opinionin publik, do të ndikonte që të ketë një lloj relaksimi të marrëdhënieve në mes të shoqërive tona, do të ndikonte në një lloj përafrimi, por do të mundësonte që shpeshherë të ndryshojë edhe gjuha e mediave, edhe gjuha e shoqërisë civile, meqë po ju them të drejtë – ndoshta nuk ma merrni për të madhe, nganjëherë mediat dhe shoqëria civile kanë pasur një qasje më konservative, më nacionaliste në raport me dialogun se sa ka pasur politika në Kosovë dhe në Serbi, kështu që kërkoj nga ju që ta mbështetni një proces të tillë, me një perspektivë më afatgjate.

Në këtë drejtim, një rol vendimtar mund të luajë edhe ballafaqimi me të kaluarën, gjetja e së vërtetës, zgjidhja e fatit të të pagjeturve, deri te dëmshpërblimet të cilat duhet të jenë pjesë e një procesi të tillë të pajtimit.

Pra, mendoj që ka ardhur koha ndoshta paralelisht me këtë dialogun në mes të dy shoqërive ne ta mendojmë dhe ri mendojmë një agjendë të mirëfilltë të pajtimit në mes Kosovës dhe Serbisë, paralelisht me procesin e normalizimit.

Së treti. Një dilemë që ne e kemi në Ballkan, dhe një dilemë që është shtruar më herët edhe me shembullin e popujve dhe shoqërive evropiane, ka të bëjë me atë që pajtimi do të jetë rezultat i ndryshimit tonë si shoqëri në Kosovë, a do të jetë rezultat i ndryshimit të thellë të shoqërisë serbe në Serbi apo do të jetë rezultat i ndryshimit të kontekstit të jashtëm.

Këtu mendoj mbi të gjitha, cili është roli i Bashkimit Evropian në një proces të tillë, a mund të ndikojnë faktorët e jashtëm, partnerët tanë edhe evropian edhe amerikanë, edhe të tjerë në një proces të tillë.

Nëse ne e kuptojmë në thelb qasjen evropiane, Euro-atlantike ndaj rajonit, në këto 15 – 20 vitet e fundit, partnerët tanë më shumë i kanë dhënë rol bashkëpunimit teknik, bashkëpunimit ekonomik, bashkëpunimit politik meqë në fund të fundit ka qenë edhe e mundur të ndodhë, sesa pajtimi si një proces ku ata kanë parë vështirësitë që ky mund të ndodhë dhe të ketë rezultate të matshme.

Unë jam i mendimit që në politikën e kondicionalitetit, në politikën e kushtëzimit të cilën e ndjek BE në raport me rajonin, dhe në konceptin e evropianizimit, pajtimi i popujve ndoshta në të

ardhmen duhet të ketë një relevancë më të madhe se sa ka aktualisht, nëse e kemi parasysht mënyrën se si matet shpeshherë progresi në rajon.

Dhe këtë nuk e them vetëm si dëshirë, po këtë e them edhe në bazë të një premise të re që e shoh në raportet Kosovë-Serbi. Pothuaj se për 100 vjet Serbia dhe Kosova kanë pasur një mënyrë interesante të leximit të marrëdhënies së tyre. Është kuptuar ajo çka definohet në gjuhën angleze si “zero sum geim”. Dikush fiton, pala tjetër humbë! Ose pala tjetër fiton, dikush humbë!

Ajo se çfarë ka ndodhur në këto pesë vite, nuk e masim me vetëm parametra kështu konkret, është se është krijuar gradualisht një raport i fitimit të dy anëve, dhe këtu mendoj mbi të gjitha agjendën integruese evropiane. Në këtë drejtim, mendoj se edhe miqtë tanë amerikanë, edhe Bashkimi Evropian do të mund ta kenë një rol më të drejtpërdrejtë në procesin e pajtimit, edhe pse unë mendoj që pajtimi është një proces i brendshëm nuk mund të ndodhë të vjen nga jashtë, por të krijojnë kornizë e kushte politike për diçka të tillë, nëse normalizimi përfundon me njohje, nëse normalizimi përfundon me integrim edhe të Kosovës, edhe të Serbisë, edhe të pjesëve tjera të rajonit në Bashkim Evropian dhe nëse normalizimi në mes të Kosovës e Serbisë përcillet në mënyre paralele me një vëmendje më të madhe se sa ka ndodhur deri me tash në procesin e pajtimit.

Unë po ndalem këtu. Natyrisht se jam i gatshëm të debatojmë për një proces të tillë edhe në mënyrë më të hollësishme, po me thënë të drejtën për pa e pa një ndryshim thelbësor, një kthesë, një shpërthim politik nuk shoh parakushte që raportet Kosovë – Serbi dhe pajtimi në mes të Kosovës e Serbisë të ketë një ardhme të sigurve.

Ku kemi qenë para 8 vitesh dhe ku jemi sot, është një ndryshim i mirëfilltë, s’po them i madh, është një ndryshim i mirëfilltë por duhet ta dimë se ku do të jemi në pesë vitet e ardhshme. Dhe nëse ne kemi caqe të matshme në pesë vitet e ardhshme, ma merr mendja që edhe procesi i pajtimit mund të ketë një dinamikë.

Zoti Blakaj, edhe një herë përgëzime për punën që po bëni. Mendoj se keni mbet një fanar i fuqishëm i procesit të pajtimit në Kosovë dhe në rajon dhe çdo kontribut që mund të jetë prej anës sonë që jemi në politikë do të mund të llogaritni.

Bekim Blakaj: Ju faleminderit shumë, profesor Hoxhaj për këtë adresim të jashtëzakonshëm. Tani fjalën ia jap zotëri Petar Milletiq. Zotëri Milletiq, urdhëroni!

Petar Miletic: Mirëdita! Para së gjithash ju faleminderit në ftesë që të jem panelist në këtë mbledhje të respektuar. Pak jam i pa disponuar të flas pas dy profesorëve, por çka të bëjë, po tentoj t’i afrohem nivelit të tyre, sa të mundem.

Pra, po tentoj të flas në këtë temë nga aktualiteti i këtij momenti dhe para së gjithash do të flas për një proces i cili është duke vazhduar, pra procesi i Brukselit, bisedimet e Brukselit dhe marrëveshjet e Brukselit të cilat janë nënshkruar dhe nga kjo pozitë të flas për pajtimin respektivisht se si ai proces në fund të fundit edhe formalisht quhet, normalizimi i marrëdhënieve.

Ndikimi i Beogradit në Serbët e Kosovës është shumë i madh. Pra shumë i madh, siç tha zotëri Puhovski për Serbët në Kroaci, mua nuk më pëlqen se sa i madh është ky ndikim. Dhe ajo për të

cilën jam përkushtuar, edhe si deputet në dy mandatet e kaluara, është që Serbët e Kosovës duhet të kenë politikën e tyre autonome dhe autoktone, së cilës Beogradi duhet ti shërbejë dhe ta ndihmojë, sepse për pozitën e rëndë të neve Serbëve nga Kosova Beogradi është përgjegjës në masë të madhe. Pra, për politikën e gabuar të Millosheviqit dhe partisë së tij, si dhe partnerëve të koalicionit të tij, ne jemi shtyrë në këtë situatë në të cilën sot ndodhemi.

Mirëpo, kjo nuk i shfuqizon të gjithë ata që pas 10. Qershorit 1999 kanë udhëhequr me Kosovën, për çka edhe sot pozita e Serbëve është e keqe. Pra, ka ardhur koha –para dy tri viteve që veriu i Kosovës të integrohet në shoqërinë kosovare, çka e përsëritet, dhe mendoj se është kontribut në normalizimin e marrëdhënieve dhe nëse doni pajtimin.

Dhe çka kanë vendosur ata të bashkësisë ndërkombëtare të cilët kanë ndikimin më të madh në Kosovë? Ata kanë vendosur kështu: Pra, në këtë me Serbët e Kosovës nuk mund ta bëjmë, na duhet me Beogradin. Kanë marrë Vuqinin si partner dhe këtë Beogradi për Zotin edhe e ka bërë. Pra, i kemi pasur zgjedhjet për herë të parë me rregullat e Kosovës, me ligjet e Kosovës, janë krijuara sidoqoftë, me shumë mungesa, komuna e Leposaviqi, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Mitrovicës Veriore, dhe ato sot funksionojnë pak a shumë në sistemin e Kosovës.

Mirëpo, çka ka pasur si pasojë nga kjo? Si pasojë Beogradi edhe më shumë është imponuar si lojtarë në skenën kosovare. Pra, Beogradi sot në mënyrë direkte vendos mbi atë se çka duhet të bëjnë dhjetë deputetë të bashkësisë Serbe në parlamentin e Kosovës, si duhet të votojnë, si duhet të sillen tre anëtarët Serb të Qeverisë? Dhe tani kemi një lloj problemi. Pra, nga njëra anë diçka kemi fituar, kemi fituar komunat serbe në veri dhe nga ana tjetër kemi fituar dhjetë deputetë të cilët janë nën kontrollin direkt të Beogradit.

Këshilla ime e parë Marko Gjiriqit i cili është shef i zyrës Për Kosovë dhe Metohi në Qeverinë e Serbisë ka qenë: Mos i shtyni Serbët në konflikt me Shqiptarët! E para dhe më e rëndësishmja, sepse në atë konflikt do ta humbasim, sepse në Kosovë jemi më të dobët, më pak jemi. Dhe e dyta, në një periudhë më të gjatë kohore ky teren do të mbetet edhe më tutje i destabilizuar.

Natyrisht, Gjiriqi nuk më ka dëgjuar dhe bën bash atë. Pra, në mënyrë konstante i shtyn Serbët e Kosovës në konflikt me Shqiptarët dhe Qeverinë e Kosovës dhe si shpërblim ata fitojnë ato, që politikisht quhen ... pikë të lira politike dhe rritjen e lirë të vlerësimit të Beogradit, të partive të tyre politike, dhe kështu me radhë.

Nga ana tjetër, as në Qeverinë e Kosovës nuk janë të ulur engjëjt, dhe as në Kuvend. Edhe nga ana tjetër unë kam vërejtur, duke punuar në institucionet, që ekziston një refleks refuzimin kur janë në pyetje të drejtat e Serbëve në Kosovë. Pra, bile në fund ne e fitojmë një rezultat, por përgjigja e parë në disa të drejta shtesë të Serbëve është refuzimi, refuzim refleksiv, bile as pa argumente.

Gjithmonë e përmend një shembull i cili është pak më simpatik, dhe ajo është kur për gjashtë muaj në Kuvendin e Kosovës jemi shtyrë për ligjin mbi Hoqën e Madhe. Unë besoj se 90% e Shqiptarëve në Kosovë as nuk e dinë ku ndodhet Hoqa e Madhe. Se a do të ulën në Këshillin e fshatit dy Serbë, tre Shqiptarë dhe një nga ...D.m.th. gjashtë muaj kemi humbur rreth një, unë do

thosha një pyetjeje të parëndësishme. Por ai refleksi i refuzimit që Serbët të fitojnë një të drejtë shtesë sepse gjoja me këtë po rrezikohet shtetësia e Kosovës, për mua është simptomatike.

Sot këtë e kemi me një pyetje serioze, dhe kjo është bashkësia e komunave Serbe. Pra, gjashtë pikat e para të marrëveshjes së Brukselit është bashkësia e komunave serbe.

Sigurisht, Beogradi luan dialog të keq, ata kanë ra në grackë dhe ngadalë kalojnë të gjitha çështjet tjera në rendin e ditës dhe bashkësia e komunave serbe mbetet në fund. Qeveria në Prishtinë ka alibi serioz se këtë nuk e bën sepse Vetëvendosje, për Zotin, kanë protesta, kanë gaz lotsjellës dhe kështu me radhë, që natyrisht nuk është një arsytim mjaftueshëm i mirë, së paku jo për mua, por në thelb ajo punë nuk po kryhet. Nuk po bëhet bashkësia e komunave serbe, e cila është një marrëveshje serioze ndërkombëtare, një detyrim serioz ndërkombëtar i Kosovës, e cila në fund duhet të zbatohet, sidoqoftë. Nuk e di, në fund do e shohim se çka do të bëhet më të.

Sa më përket mua, bashkësia e komunave serbe nuk është dashur medoemos të ekzistojë, dhe nuk ka qenë e domosdoshme për Serbët. Ata kanë pas mekanizma seriozë, vetëm po të ishin zhvilluar me kohë këta mekanizma. Por meqenëse është nënshkruar, dhe kur është tashmë në letër, dhe kur tashmë janë zotuar palët që këtë do ta përmbushin, atëherë, mendoj se, duhet në fund edhe të jetësohet.

Pra, po e përfundoj me këtë, dialogu në Bruksel dhe dialogu në mes të Beogradit dhe Prishtinës, apo Kosovës dhe Serbisë, nuk është dialog në mes të dy shoqërive, ky është dialog në mes të dy qeverive, dhe kjo nuk po lëshohet në teren. Pra, këtu nuk bëhet fjalë për pajtimin e Kosovës dhe Serbisë. Këtu bëhet fjalë për pajtimin në mes të Serbëve dhe Shqiptarëve.

Ky proces nuk po shkon në atë drejtim. Pra, nuk ka dialog në mes të Serbëve dhe Shqiptarëve, por ka dialog në mes të Vuçiqit dhe Mustafës, ose më parë në mes të Daçiqit dhe Thaqit. Pra, në vend që marrëveshja e Brukselit dhe bisedimet e Brukselit t'i kontribuojnë pajtimit, ai na largon nga kjo.

Rritja e nivelit në mos pranimin e Kosovës në UNESCO është vërejtur në teren. Pra, unë çdo ditë komunikoj me njerëzit të cilët punojnë në institucionet e Kosovës, të cilët janë Serbë dhe të cilët thonë: Ejj, raporti i kolegëve të mi Shqiptarë pas këtij vendimi është ndryshuar ndaj meje. Unë, thotë, e kam vërejtur këtë. Janë më të ftohtë, nuk lajmërohen në korridor, nuk pimë kafe bashkë. Pra, ajo ngritje e tensioneve është shumë keq.

Dhe në fund, gjykata speciale! Unë nuk kam njoftuar asnjë Shqiptarë i cili thotë se gjykata speciale është e domosdoshme për Kosovën për t'u pastruar me kryerjen eventuale të krimeve të luftës. Kam takuar disa që thonë, e mirë është gjykata speciale, por vetëm që garnitura ekzistuese të shkojë në Hagë në mënyrë që ne të vijmë në pushtet të Kosovës. Përndryshe, ata të cilët vërtetë mendojnë se gjykata speciale është e domosdoshme për Kosovën, në mesin e Shqiptarëve unë ende nuk i kam takuar.

Gjithashtu nuk mund të them se ka shumë Serbë të cilët thonë se tribunali i Hagës ka qenë pozitiv në ballafaqimin e Serbëve me atë se çka kanë bërë disa Serbë. Mua personalisht më vije turp për ata policë dhe ushtarë Serbë të cilët në emrin tim kanë bërë ndonjë krim. Apo cilido, i

cili në kapelë ka bartur shenjën e Serbisë apo ndonjë shenjë serbe dhe e ka vrrarë ndonjë civil apo ka dhunuar ndonjë femër. Mua më të vërtetë më vije turp për shkak të Serbëve të tillë!

Mendoj se kjo ndjenjë duhet të futet në të gjithë ne në rajon, sepse, siç tha profesori, nuk ka përgjegjësi 100 ndaj 0. Do të thotë se përgjegjës ka në të gjitha anët dhe mos të futemi në matje se kush sa është përgjegjës. Ju faleminderit edhe njëherë në ftesë që të marr pjesë dhe ky ishte kontributi im.

Bekim Blakaj: Ju faleminderit shumë zotëri Milletiq! Tash do t'ia jap fjalën zotëri Ardian Arifaj. Urdhëroni, zoti Arifaj!

Ardian Arifaj: Faleminderit zoti Blakaj! Falënderoj për ftesën që të jam këtu në këtë panel. Falënderoj edhe parafolësit dhe mirë që më dhatë fjalën para zotëri Vllasi, sepse me pas fol edhe ai, s'kishte mbet kurrjë për mua!

Atëherë, unë ndoshta nuk dalloj shumë nga ajo që thanë edhe parafolësit. Problemi i pajtimit sa është konkret, është edhe të themi pak filozofik. Edhe atë që e tha profesor Hoxhaj, nuk di, t'ia jep dorën atje. Ajo që është qenësore për pajtim, por që nuk po ndodhë, është në fakt nevoja që të ndryshojmë narativët që i kemi për njëri tjetrin, për veten, për marrëdhëniet që i kemi me njëri tjetrin, por edhe për të tjerët.

Është ky narativ i cili ka shkaktuar luftëra, i cili ka sjell armiqësi në mes të popujve të Ballkanit dhe është ky narativ ai i cili pengon edhe pajtimin e mirëfilltë në mes të popujve të Ballkanit.

Për fat të keq, deri tash nuk shohim se ka përpjekje për t'u përballur dhe për të ndryshuar në fakt narativin. Thashë narativin që e kemi për veten, por pastaj edhe për marrëdhëniet që i kemi me tjerët dhe për të tjerët.

Një pjesë e pyetjeve ishte se çfarë mund të bëjë politika dhe politikanët. Në fakt, politikanët si u përmend edhe më herët, me disa gjeste simbolike, mund të kontribuojnë që të thehet akulli në mes popujve, të fillojë dialogu në mes popujve, të fillojë ajo që e quajtmë këtu normalizimi i marrëdhënieve në mes të popujve dhe pastaj ky normalizim të sjellë deri te pajtimi i mirëfilltë.

... në rastin e Kosovës, po shohin që është instaluar një proces i dialogimit, mund të themi që kemi një komunikim gati se normal në mes Kosovës e Serbisë. Liderët politikë takohen edhe në kuadër të dialogut në Bruksel, por edhe në forume tjera, siç kemi pasur për shembull këtë forumin e "6 vendeve të Ballkanit Perëndimor". Aty hyn edhe roli i BE-së, sepse po kërkohet edhe ku është roli i BE-së, e kemi procesin e Berlinit, i cili po parasheh ndërtimin e autostradave, hekurudhave, që do t'i lidhin edhe më mirë popujt e Ballkanit perëndimor, si do ta përmirësojnë komunikimin, bashkëpunimin në mes të popujve të Ballkanit perëndimor, po edhe me e lidh Ballkanin perëndimor me Evropën dhe e gjitha kjo me idenë që prapë të ndihmohet pajtimi në mes popujve.

Përsëri pyetja është: A mjafton kjo, dhe a po ndodhë në t'vërtetë ky pajtim? Dhe, sa herë që të themi e shikojmë në mënyrë kritike shohim se në fakt edhe këta hapa të politikës nuk po sjellin një pajtim të mirëfilltë. E kjo përsëri më kthen, se edhe unë në fakt jam filozof, te ajo që them te nevoja për të ndryshuar narativët, atë që e tha edhe profesor Hoxhaj më herët te nevoja për një

dialog në mes shoqërive. Por e para, duhet një dialog me vetveten, një dialog i singërte me vetveten, që të shohim se cila ka qenë pjesa jonë e përgjegjësive dhe pastaj të shohim cili është roli ynë në pajtim dhe pastaj dialogu me të tjerët.

Ndoshta kjo është ajo hallka e parë që po mungon dialogu i brendshëm me vetveten për të parë se cilat janë përgjegjësitë tona apo te pyetjet apo tezat që ishin nga profesori për të parë se ka përfunduar lufta, cilat kanë qenë pasojat dhe cila është përgjegjësia jonë për luftën por edhe për paqen.

Pra, është nevoja të kemi një dialog të mirëfilltë të tërë shoqërisë. Për ndryshimin e narativëve nuk janë përgjegjës vetëm klasa politike por është përgjegjësia edhe e Akademisë, e artistëve, është përgjegjësi e mediave, është përgjegjësi e shoqërisë civile. Nuk po themi se nuk janë duke e kryer punën por vetëm po dëshirojmë të tregojmë se sa kompleks është ky proces i ndryshimit të narativëve.

Edhe kur shohim në fakt se çfarë po ndodhë, kur i lexojmë mediat, e shohim se nuk kemi ecur, nuk kemi lëvizur shumë në drejtim të ndryshimit të narativëve, përkundër rastit të Kosovës e Serbisë – dialogun që e kemi, shohim se të dy shoqëritë ende janë të ngujuara në narativët që i kanë për veti dhe për tjetrin. Mjafton me i lexuar një ditë mediat e Serbisë dhe me pa se çfarë gjuhe përdoret. Është e tmerrshme me i pa anketat që zhvillohen në Serbi, me pa se kush cilësohet si armiku kryesor, çfarë gjuhe përdoret, në këtë rast kur po flasim për Kosovën se çfarë gjuhe përdoret për Kosovën. Mos ta përsëris edhe unë, u pa me rastin e UNESCO-s se si dual përsëri në sipërfaqe ai narativi i vjetër që e ka shkaktuar urrejtjen, që e ka shkaktuar luftën, që i ka shkaktuar të gjitha ato vuajtje por edhe që sot e asaj dite është pengesë për një pajtim të mirëfilltë.

E tha edhe zoti Miletij para meje që dialogu në mes Kosovës e Serbisë nuk është duke i kontribuar singërisht pajtimit në mes popujve. Është dialog në mes të politikanëve, në mes të qeverive, por jo edhe në mes të popujve dhe për më tepër rrezikon që në fakt të largojë popujt prej pajtimit të mirëfilltë.

Prandaj, për një pajtim të mirëfilltë duhet si shoqëri të prekim dialogun dhe normalisht politika mund të ndihmojë duke qenë lider, sikur që është tash, me takime por nuk mjafton vetëm klasa politike që të kemi pajtim të mirëfilltë. Faleminderit!

Bekim Blakaj: Ju faleminderit shumë zotëri Arifaj! Ju faleminderit për gatishmërinë për të marrë pjesë në këtë debat, edhe pse ftesa ka qenë jashtëzakonisht e vonshme. Fjalën do t'ia japim zotëri Vllasit! Urdhëroni!

Azem Vllasi: Faleminderit shumë! Së pari falënderoj për ftesën dhe shpreh kënaqësinë time që jam në prezencë të njerëzve këtu që folën me shumë kompetencë për këtë temë. E tash, pasi jam i fundit dhe kur të ju premtoj se unë do të jam i shkurtër, më dëgjoni me vëmendje.

Ne po bisedojmë për një temë e cila gjithmonë është temë aktuale pas konflikteve, pas luftërave, dhe kur flasim për një temë e cila është proces i gjatë, pas do luftërave është proces më i gjatë, po

është edhe i dhimbshëm, diku thonë hajde ta lëmë atë çka ka ndodhur mbrapa, e t'i kthehemi të ardhmes. Por këtu në Ballkan mjerisht ky proces shkon ngadalë.

Me rëndësi është më së pari te të gjitha palët të them, që ishin të involvuara në konflikte, që u shkaktuan pasoja dhe tash kanë nevojë për pajtim, e rëndësishme është që te të gjithë të mbizotërojë vetëdija se pajtimi është i nevojshëm dhe është në interes të secilës palë dhe pajtimi nuk bëhet për hatër të atij tjetrit.

E dyta. Duhet për të pasur durim, të kuptohet se... Më fal, ndoshta po e përsëris se profesor Hoxhaj e tha, është një proces dhe jo një ngjarje apo punë e një vendimi, dikush ka marrë vendim diku të pajtohem dhe tash e tutje jemi të pajtuar. Jo, ajo është një proces.

Por tash, cilët janë faktorët të cilët atë proces e shtyjnë përpara dhe pajtimin e bëjnë proces më të shpejtë dhe cilët janë faktorët dhe rrethanat të cilët e ngadalësojnë.

Mjerisht në këto treva, të ish Jugosllavisë, më shumë ka faktorë që e pengojnë procesin e pajtimit se sa që ka mbizotëruar vetëdija se pajtimi është i nevojshëm. Së pari, në struktura shtetërore udhëheqëse politike, dhe po i marr këto vendet që kemi qenë të përfshira në luftë, Serbia, Kroacia, Bosnja e Kosova, akoma janë në pushtet të fuqishëm njerëz që ose kanë dalë në skenën politike gjatë kohës së konflikteve ose kanë qenë pjesëmarrës direkt. Dhe të njëjtit njerëz nuk mund ta realizojnë procesin e pajtimit. Duhet të vijnë do gjenerata, do njerëz tjerë, madje patjetër edhe gjenerata të reja.

Problemi kryesor te fakti se i kemi në udhëheqësi njerëz të cilët kanë qenë në politikat e luftërave të involvuar, problemi më i madh është te Serbia. Pse te Serbia? Sepse Serbia i ka nisur të gjitha ato luftëra, nga Beogradi janë nisur luftërat. Profesorë Puhoski me të drejtë tha lufta s'ka 100 me 0. Dikush 100% fajtorë, sepse luftërat qofshin të drejta, nëse janë mbrojtëse, qofshin të padrejta nëse janë agresive, ama në lufta nuk janë me një anë vetëm engjëjt e në anën tjetër vetëm djajt. Prandaj, formohen gjykata, prandaj edhe Gjykata e Hagës është marrë me krime të lufta, e tjera, por te Serbia është një problem se struktura e njëjtë e dalë nga lufta nxitëse, madje shumë prej tyre kanë qenë drejtpërdrejt në terren në luftë, sot janë në vende kyçe në pushtet të Serbisë, prej kryetarit, kryeministrit, ministrit të jashtëm e që ishte kryeministër dhe e kemi pa fjalorin e ministrit të Drejtësisë, merreni me mend, të drejtësisë, i cili ka qenë në ato protestat e asaj organizatës fashiste ... i thonë, ai flet... ai është një njeri ekstremist, jo nacionalist në atë kuptimin, por është ekstremist dhe kanë dalë gjenerata të reja të cilat kanë mbet në atë lëvizhjen e asaj politike e cila ka prur deri te konfliktet.

Problemi i dytë. Nga Serbia e kemi një konstantë. Nën një, tendenca që të barazohet fajësia për konfliktet që kanë qenë. Gjykata e Hagës akuzohet se më shumë po gjykon serbë... Merre me mend më shumë serbë, se qenka dashur më shumë boshnjakë, kroatë apo shqiptarë me i gjykuar.

E treta. Opinioni, dhe të ndalem pak e mos të bëj ekskursionë të mëdha, por vetëm të shtoj këtë. Lidhur me Kroacinë, aksionin ushtarak policor i cili e ka ribashkuar territorialisht dhe gjeografikisht Kroacinë, të cilën e patën këputë për mjedis serbët, me atë që u thonë "Oluja", në Beograd zyrtarisht quhet "krim i pandëshkuar". "Oluja je bila zločin bez kazne". Professore Puhoski ju e dini më mirë se si thonin ata.

Për Srebrenicën e dini sa përpjekjet i kanë bërë dhe më në fund me votën e “mamës Rusi” e kanë penguar të gjykohet, verbalisht do të thotë me një rezolutë të Kombeve të Bashkuara që do të kishte domethënie të madhe për procesin e pajtimit, mos me u gjykua gjenocidi në Srebrenicë i cili është vërtetuar me aktgjykime fuqiplote të Gjykatës së Hagës.

Dhe së fundi, e të kaloj dy-tri teza që i kam lidhur me Kosovën. Opinioni serb sot e kësaj dite nuk e din krejt të vërtetën çka ka ndodhë në Kosovë në vitin 1998-1999 përveç se thonë forcat serbe kanë luftuar këtu kundër terroristeve, e kanë mbrojtur Serbinë, e kanë mbrojtur Kosovën. Madje asnjë fjalë s’thuhet, e po pse erdhi deri te konflikti luftarak, pse u dashtë të dilet me pushkë në dorë për ta mbrojt këtë Kosovë kur e shkelën Kushtetutën e 1974, e tjera, e tjera dhe kjo e pengon, bezbeli, procesin e pajtimit.

Ne në Kosovë, me serbët e Kosovës kurrë s’kemi pasur problem e as nuk do të kemi dhe as që duhet të kemi problem. Ne kemi pasur problem me Serbinë, po edhe sot kemi problem me Serbinë.

Unë i kam fshirë do teza të mia, e zoti Miletiq foli shumë mirë dhe i bjen më tepër të flet për këtë temë. Serbët e Kosovës, edhe në këtë kohë janë pru në një situatë të palakmueshme duke u dhënë sugjerime të drejtpërdrejta nga Beogradi se deputetët serbë në Kuvendin e Kosovës janë për t’i mbrojtur interesat e Serbisë në Kosovë, jo për ta përfaqësuar komunitetin e vet që i ka votuar dhe për të luftuar për interesat dhe nevojat e tyre.

E dyta. Pa marrë parasysh, procesi i Brukselit, ani që po zhvillohet dhe emrin mirë e ka – për normalizim, jo për pajtim, në momente i ngjanë një farsë sepse Serbia për derisa me një anë krejt atë retorikën dhe veprimtarinë anti Kosovës e ka në aksion të plotë dhe në anën tjetër në Bruksel bëjnë negociata, ajo duket si farsë.

Më duket se në këtë regjion momentalisht, jo që procesi i pajtimit nuk ka mbërri, nuk ka perspektivë të dukshme e të mirë, e mos të them të afërt jo se jo, por duket si një gjendje të armëpushimit dhe kurrkush nuk është më i vullnetshëm të hyjë në konflikte të reja, madje as Serbia, por Serbia jeton në një armëpushim me shtetet përreth veti sepse nuk i ka realizuar ambiciet që i ka pas për të cilat i ka nisë konfliktet dhe i kanë mbetur si punë të pakrye, siç thonë. E ku shihet kjo? Shihet në çështjen e Kosovës shumë qartë se në secilën mënyrë thotë “to je juzhna srpska pokrajina”. Nuk ka shtet, s’ka shtet, dialogu në mes Beogradit e Prishtinës jo në mes të Serbisë e Kosovës, e tjera, për Kosovë krejt e dimë çfarë qëndrimi kanë.

Ndaj Malit të Zi, bashkë me Rusinë janë duke vepruar në mënyrë që gjithsesi të sabotojnë politikën e vet që e bën Mali i Zi si shtet dhe anëtarësimi të Malit të Zi në NATO.

Përkrahja e entitetit serb në Bosnje e Hercegovinë, ka për qëllim të drejtpërdrejt që Bosnja si shtet të mos ekzistojë dhe një ditë Republika Srpska si entitet serb t’i krijon shancat t’i bashkëngjitet Serbisë.

Dhe, interesant! Këto aspirata, edhe më shumë shprehen prej se ia ka nisur Rusia pak të silltet kështu pak më arrogante, kishë është konsoliduar dhe mund ta bombardojë në Siri dhe mund të gllabëritë pjesë të Ukrainës, e tjera. Dhe më duket nganjëherë, ky kryetari i Serbisë Tomisllav

Nikoliq kur s'ka çka të bëjë e thërret ambasadorin e Rusisë t'i qet kafe dhe një herë me ia shpreh dashninë e madhe, lojalitetin që e ka Serbia, sikur që e dimë, ndaj Rusisë.

Prandaj, përzjerja e Rusisë, që duket ashiqare, në serbi po se po, edhe në çështjet e Malit të Zi, edhe në entitetin serb, mund ta keqësojë jo vetëm gjendjen e sigurisë në rajon, atë po se po, por edhe procesin e pajtimit.

Neve këtu na mbetet të pajtohemi me një realitet dhe ne s'mund t'ia ndryshojmë dhe ndërrojmë mendjen Serbisë, por unë mendoj që në mes të Kosovës dhe Serbisë, në mes shqiptarëve dhe serbëve duhet të vjen deri te një normalizim i raporteve, një relaksim i raporteve dhe kontributin më të madhe do ta japim për atë proces, edhe unë do ta quaj, të pajtimit dhe jo vetëm të normalizimit, nëse Kosova si shtet përbrenda konsolidohet.

Srbia një ditë do të kuptojë se Kosova si shtet, Kosova jashtë Serbisë është një realitet i pakthyesëm, por për deri sa ne të bëjmë kështu çfarë jemi duke i bërë shtetit tonë, ata po i fërkojnë duart dhe po thonë – po ndoshta edhe ka ndonjëfarë shprese, barem për ndonjë pjesë të Kosovës.

Këto ishin pra disa mendime të mia që desha t'i them lidhur me këtë temë. Faleminderit!

Bekim Blakaj: Ju faleminderit shumë, zotri Vllasi! Faleminderit edhe audiencës dhe jam i sigurt që shumë prej juve mezi prisni të merrni fjalën për komentet tuaja, për pyetje ndaj panelistëve, e kështu me radhë. Besoj se e kemi një mikrofon lëvizës diku. Urdhëroni ju zotëri!

Ismail Muçiqi: Unë jam Imail Muciqi i shoqërisë civile. Desha të shtroj mendimin tim për debatin që u bë, por e kam një pyetje konkrete për zotëriun Miletiq.

Unë e dëgjova mbrëmë dhe sot presidentin Nikoliq i cili deklaroi se pas hapjes së kapitullit 35 të Bashkimit Evropian në raport Kosovë – Serbi, ne patjetër duhet ta pyesim kishën ortodokse se çka duhet bërë.

Po dua ta di edhe mendimin e zotit Miletiq dhe për forcat progresive që zhvillojnë aktivitet në Kosovë se deri kur Kisha ortodokse serbe po e dikton politikën e Serbisë në Kosovë dhe deri sa kjo ekziston unë jam shumë skeptik se ne mund të ecim përpara. Vetëm kaq, faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit për pyetjen! Unë nuk e di që është personi i duhur zoti Miletiq të përgjigjet në këtë pyetje, por nëse dëshironi, mund ta merrni fjalën.

Petar Miletic: Shumë shkurt! Mendoj se kisha Serbe nuk dikton politikën e Beogradit, dhe kjo është e stërmadhuar. Ndërsa e vërtetë është që kisha Serbe ka ndikim të rëndësishëm në shoqërinë Serbe. Nuk mendoj se është mirë që ajo të diktojë gjithçka, dhe mendoj se deklarata e presidentit Nikolliq, i cili pos kishës serbe ka shtuar edhe akademinë e shkencave dhe artit të Serbisë, në fakt është ikje nga përgjegjësia. Asgjë tjetër!

Bekim Blakaj: Ju faleminderit zotëri Miletiq! A e dëshiron edhe ndokush fjalën? Po, ai atje mbrapa e do fjalën. Ju lutem të përmbaheni në temë, nëse ka mundësi!

Taulant Osmani: Jam Taulant Osmani, prej televizionit Rrokum. Dy pyetje i kam për zotin Miletiq. Po flasim për procesin e pajtimit dhe 3 apo 4 muaj më parë kryeministri serb e ka dhënë një ide që të kenë një datë përkujtimore për të gjitha viktimat e luftës së ish Jugosllavisë dhe është çështje kategorikisht i të gjithë liderëve të shteteve të Ballkanit. A mendoni që kjo ide kishte mund t'i kontribuojë ndoshta procesit të pajtimit dhe deri kur, ose në çfarë afati mund të vjen kjo.

Dhe diçka tjetër, e përmende gjatë fjalimit tuaj, asociacionin e komunave me shumicë serbe. A mendoni që po krijohet një shtet brenda shtetit, apo një Bosnje e re me një republikë serbe brenda Bosnjes njëjtë me këtë në Kosovë? Faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit! Urdhëroni zotëri Miletiq!

Petar Miletić: Sa i përket pyetjes së parë, mendoj se vet e keni dhënë përgjigjen. Ajo ide të cilën e ka nxjerrë kryeministri i Serbisë Vuçiq nuk është pranuar. Pra, nuk është pranuar, dhe mendoj se kjo është tanimë add-akta.

Personalisht nuk jam ithtar i simbolikave të stërmëdha. Unë më shumë pëlqej veprimet praktike. Nuk do kisha asgjë kundër që diçka e tillë të ekzistojë por nëse kjo ka gjetur refuzim të tillë tek të tjerët atëherë kam frikë se ajo ide është tanimë e vdekur.

Sa i përket bashkësisë së komunave serbe dhe bosnjizimit të Kosovës, siç thuhet shpesh, mendoj se ky rrezik nuk ekziston. Arsyeja më e rëndësishme është që komunat të cilat duhet të bashkohen në bashkësi nuk janë gjeografikisht të lidhura, dhe kjo është e qartë. I kemi këto katër në veri të cilat janë të lidhura gjeografikisht, dhe gjashtë në jug të Ibrit të cilat janë gjeografikisht të shpërndara.

Nga ana tjetër nuk mendoj se ajo bashkësi do ketë aso kompetenca siç i ka republika Serbe në Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe unë mendoj se frikësimi i njerëzve me bosnizim të Kosovës në fakt vetëm njëra ndër mënyrat që të shtyhet apo të braktiset themelimi i bashkësisë me komuna serbe.

Ajo se cka mendoj unë që bashkësia e komunave serbe duhet të jetë është që të merr disa punë si institucion i Kosovës nga Republika e Serbisë, punë të cilat kjo e fundit i kryen në Kosovë. Pra, Republika e Serbisë sot i ka disa institucione të cilat funksionojnë në Kosovë.

Kam frikë se ekziston një numër i tillë i njerëzve të punësuar në institucionet e Republikës së Serbisë në Kosovë, sa që Kosova momentalisht nuk është e gatshme t'i absorbojë atë numër të njerëzve dhe kam frikë se ata mund të jenë një bombë serioze sociale e cila mundet lehtë të eksplodojë, gjë që nuk di ishte kurrsesi mirë as për Kosovën.

Pra, mendoj se ky është njëri ndër rolet kyqje të bashkësisë së komunave serbe, shkollat, spitalet, shtëpitë e shëndetit, disa institucione sociale të cilat kishin mundur që, pas formimit të

bashkësisë së komunave serbe, të funksionojnë legalisht, që të dimë ku shkon paraja, sipas cilave procedura dhe kështu me radhë, që mos ta zgjas.

Bekim Blakaj: Ju faleminderit zotëri Milletiq! Urdhëroni, ju që e keni kërkuar fjalën!

Mimoza Telaku: Përshëndetje! Unë quhem Mimoza Telaku, jam doktorante në Universitetin ... Përshëndes panelistët!

Desha të kthehem në temën konkrete të pajtimit, të reflektohen dhe debatohen lidhur me atë që e shprehën panelistët.

Desha të potencoj rëndësinë e qasjes së dyanshme nga aspekti i lartë dhe poshtë të pajtimit.

Dua të theksoj një barrierë shumë serioze, sa i përket nivelit të sipërm të pajtimit sa i përket elitës politike. Kemi një barrierë që po e quajnë nacionalizëm instrumental, i cili shfrytëzohet zakonisht për zhvillimin e politikave ditore. Zakonisht përdoren në media deklarata të ndryshme për këtë çështje.

Sa i përket nivelit të poshtëm të pajtimit, nivelit qytetar, qytetar të rëndomtë, dua të them se ekziston mungesë e kontaktit në mes grupeve etnike në konflikt. Kemi pasur luftë dhe konflikte të armatosura në ish Jugosllavi dhe kemi një sistematizim të grupeve etnike në enklava të cilat e kanë penguar kontaktin ndëretnik dhe në të njëjtën kohë kanë penguar ballafaqimin edhe me të kaluarën, që në qoftë se promovohet kontakti ndëretnik ndoshta do të ndihmonte në ndryshimin e narrativëve siç i përmendi zoti Arifaj.

Po ashtu, desha t'ju parashtroj një pyetje sa i përket indikatorëve të pajtimit, nga niveli i poshtëm i pajtimit, nga niveli qytetar. U fol shumë për nivelin e sipërm, për indikatorë të shumtë të këtij procesi.

Do të fokusohem sidomos në Kosovë. Të cilët janë indikatorët që tregojnë një proces të pajtimit në nivelin qytetar? Për mua është njëjtë, cilido panelit që mund të përgjigjet.

Bekim Blakaj: Ju faleminderit shumë për komentet dhe për pyetjen. Zotëri Vllasi u lajmërua për përgjigje!

Azem Vllasi: Unë mund të përgjigjem në këtë pyetje, sepse unë jam avokat dhe jam në kontakte të shumta me njerëz të rëndomtë të gjitha nacionaliteteve.

Pajtimi, një lloj i pajtimit në nivel të ulët, si thoni ju, në mes të qytetarëve shkon më shpejt se procesi i pajtimit apo të rregullimit të raporteve në nivele më të larta. Dy – tri katër vite, pas 1999, pas asaj kthesës së madhe, me të vërtetë ishte problem të kontaktojnë serbët me shqiptarët. Më vonë ai proces ka filluar, njerëzit kontaktojnë në baza të ndryshme, prej komshiut me komshiun, nëse s'kanë bërë diçka të keqe të kontaktojnë dhe kah Anamorava është pak më prezente ajo.

E dyta. Në raporte tregtare, shit-blerje, e tjera, e tjera, por ato janë kontakte në mes njerëzve, ai proces në nivel të ulët në mes popullit mund të ju them goxha ka ecur përpara dhe ecë më shpejtë

dhe më normalisht se në nivele, siç thatë ju, të larta. Unë ju flas për atë sa unë kam njohuri nga jeta e përditshme.

Bekim Blakaj: Faleminderit zotëri Vllasi! Fjalën e ka kërkuar edhe profesor Puhovski dhe pastaj edhe profesor Hoxhaj. Urdhëroni!

Žarko Puhovski: Përsëri ne kemi fenomene të paqarta. Me 30 Dhjetor do të shkojnë nga Lubjana dy trena të veçanta në Beograd dhe rreth 30 autobusë. Asnjëherë në Jugosllavi Beogradi nuk ishte aq në Lubjanë siç është sot. Nga Zagrebi do të shkojë rreth 50 autobusë sepse për të rinjtë e Zagrebit dhe Lubjanës beogradasit janë shenjë dhe ajo tani mund të quhet normalizim, për pjesën time, por është normalizimi idiot. Pra, ky është normalizimi duke supozuar se asgjë që e bën normalizimin është e nevojshme ... Sikur mos të kishte ndodhur asgjë. Dhe kjo është më e lehtë, të gjitha do të pranojë.

Është i shkëlqyeshëm, Beogradi është qyteti me të vërtetë simpatik dhe në Beograd është me të vërtetë mirë për të qenë, të gjithë e dinë, por kjo nuk ndryshon gjërat që kanë ndodhur dhe ndodhin. Pra, çfarë është qëndrimi im? Unë nuk mund të jem kundër tij, në të kundërtën, le të shkojnë, është e mirë për të parë se serbët nuk do po i 'u rriten brirët mbi kokë, dhe Kroatëve gjithsesi, me përjashtim të ... Por kjo nuk është më një problem.

Së dyti, nga pikë vështrimi i nacionalistëve serbë, që të jemi krejt të qartë, është i mundshëm të bisedohet normalisht me Kroatë, me Sllovenë, nuk është i mundshëm bisedimi me Shqiptarët dhe Muslimanët, dhe ky mbetet problem afatgjatë. Pra, ata mund të përpijnë Kroacinë, nëse duhet. Munden Slloveninë, mundem Maqedoninë. Me të vërtetë mbetet problem i hapur, unë do guxoja edhe ta quaja, përbuzja ndaj Shqiptarëve dhe Muslimanëve si ka aty elemente të racizmit, nuk janë me elemente të nacionalizmit. Sepse nacionalizmi mund të pranojë palën tjetër në disa çështje, dhe superiore si armik, të ashtuquajturin armik i ndershëm. Por racizmi shikon nga lart deri ... dhe kjo mbetet problem. Kjo vlen në të gjitha hapësirat tona për Romë, sidomos. Kjo ekziston.

Dhe këtu me të vërtetë është problem. Këtu duhet gjenerata të tëra, për të ndryshuar diçka dhe me të vërtetë më duket tragjikomike ai argëtim nëpër Beograd dhe kështu me radhë, dhe nga ana tjetër vetëm kjo ana perëndimore në njëfarë mënyre po normalizohet, e tek pastaj ndoshta do shkojnë më tutje. Nëse me të vërtetë kjo do të ndodhë.

Ne kemi një problem në mbarë botën që ketë e vendos në harresë, dhe kjo është, unë do të thoja edhe histeri, e luftës kundër terrorizmit, ku muslimanët shfaqen si internim i së keqes. Për të marrë vetëm një shembull. Viktimat e terrorizmit në Paris ... janë dy herë më pak se viktimat në aeroplanin rus, disa ditë para kësaj. Askush nuk ka ndezur qirin për viktimat e terrorizmit në aeroplan rus, por në Paris. Sepse perëndimi përballet me kërcënimin islamist musliman, dhe kjo është diçka që normalisht rëndon pozitën e kombit shqiptarë dhe muslimanë ndaj...

Në këtë kontekst, për mua është krejtësisht e paqartë dhe këtë e them, si ndodh që nga ana e shqiptarëve nuk theksohet që Shqiptarët janë kombi i vetëm me tri religjione me traditë autoktone, por pranojnë me lidhshmërinë e njëanshme me adresën muslimane, e cila është shumicë por nuk është.... Dhe kjo është një vlerë që më të vërtetë askush në Evropë nuk e ka, e

cila krejtësisht në mënyrë propagandistike nuk është shfrytëzuar. Kur them propagandistike mendoj në propagandimin e fakteve, nuk mendoj në propagandë tuajën. Prapë kthehem, gjyshi im ka qenë shqiptarë katolik. Unë secilit ... duhet ... t'i tregoj se çka është Shqiptarë katolik. Prej nga tash ka Shqiptarë katolik, Shqiptarë ortodoks. Pra, kjo është diçka që nuk e shfrytëzon as Shqipëria as Kosova, dhe kjo tash mund të jetë sëpate mbi kokë sepse mendoj se histeria për shkaka të terrorizmit do të përhapet ende. Dikush më herët e përmendi Putinin. Putinin në fakt i 'u është falur Ukraina kur ka hyrë në luftë të përbashkët kundër ISIL-it në Siri dhe Irak. Ky është fakt.

Dhe tani çka tjetër mund të ndodhë, nëse vije te kjo? Pra, sikurse në vitin 39 gjithçka i ka ndodhë Stalinit ... ai ka qenë në pozitë të jesh apo të mos jesh. Mirëpo, tani mendoj se nuk është të jesh apo të mos jesh, por vetëm pakica, shumica mendojnë se ai është një rrezik dhe për këtë duhet folur kur dhjetë herë më shumë njerëz të vriten në Siri, ky nuk është problem, dhe kur vriten njerëzit në Pariz, ky është problem botëror.

Dje një person është vrarë për shkak të një kushërire në Amerikë, dhe kjo gjendet në të gjitha lajmet me pesë herë më shumë hapësirë se sa vrasja e 52 njerëzve në Irak, në të njëjtën ditë. Ky është realiteti i botës, ky është realiteti i bashkimit Evropian, ky është realiteti i Amerikës të cilët diktojnë klimën botërore dhe në këtë duhet në një mënyrë ... për fat të keq, mund të tentojmë ta sabotojmë pak, por nuk mund ta ndryshojmë. Mendoj se nga jashtë kjo ndikon negativisht në pozitën tonë, duke përfshirë edhe të gjitha ato elemente vendore që i përmenda. Ju faleminderit shumë!

Bekim Blakaj: Faleminderit shumë! Profesor Hoxhaj!

Enver Hoxhaj: Faleminderit shumë Bekim!

Sa i takon pyetjes dhe komentit të fundit, a e përdorim nacionalizmin si instrument politik. Mendimi im është që kjo duhet të shihet në dy nivele, ose përjashtojmë mundësinë që një pjesë e jona shpeshherë nuk kanë narracion tjetër, siç tha zoti Arifaj, përveç një narracioni me të cilin kemi lind dhe në mënyrë të vetëdijshme a të pavetëdijshme nuk dimë që ta ndryshojmë gjuhën.

Përtej kësaj, kur je vendimmarrës, jo në kuptimin e nacionalizmit, por në kuptimin e një real politike, të asaj se çfarë ndodhë, je i detyruar që të sillesh në formën se si duhet të sillesh. Çfarë nënkupton kjo në raport me Kosovën, në raport me Serbinë?

Kosova nuk është shtet anëtar e OKB-së dhe nëse nuk je shtet anëtar i OKB-së ti duhet ta keshë një qasje, të paktën mos të jesh naiv në atë se çfarë thua dhe çfarë bën në baza ditore. Është një shqetësim real për ekzistencën tonë si shtet, se ku do të jemi në 5 vitet, 10 vitet e ardhshme.

Çka tregon, për shembull, mosantaresimi i Kosovës në UNESCO? Ju jeni hulumtues, jeni në Izrael si Bengurio, tregon se Serbia nuk është e gatshme ta lejojë Kosovën të jetë pjesë e një organizate e cila mbi të gjitha prioritet të parë ka arsimin. Prioriteti i parë i UNESCO-s nuk është trashëgimia, por është arsimit, merret me auditimin e arsimit fillor, arsimit të mesëm, mbikëqyrë cilat janë standardet, qysh mund të përmirësohet cilësia në arsim, çfarë roli kanë mësimdhënësit në shkollë, cilat duhet të jenë kualifikimi i tyre. Dhe unë i njoh këto punë goxha në detale, sepse çdo vit lexoj raportet e UNESCO-s për shkak të interesit tim si njeri në politikë. Merret me ri-serch. Tash imaxhino, do të thotë të keni kampanjë në 2015 e cila pengon një

komunitet të hulumtuesve, të profesorëve, të akademikëve që të kenë qasje në programe të UNESCO-s. Mandej, jo në kuptimin e nacionalizmit por të funksionimit ditor, ne kemi arritur një marrëveshje e cila s'ka qenë e lehtë, ka qenë e dhembshme në raport me Serbinë, ajo marrëveshja e fusnotës, pjesëmarrja në anëtarësim në organizatat rajonale. Unë këtu e kam një listë të gjatë të sms, katër viteve të fundit, jo vetëm për anëtarësim por shpeshherë për pjesëmarrje. Delegacionet tona, prej atyre të ambientit e deri te ato që merren me siguri kanë arritur në një konferencë, s'kanë mund të hyjnë në konferencë, domethënë është dashur të thirrni dikë në Bruksel. Me Fuhle zakonisht. Me Stefan Fyhle kanë lloj sms, në baza ditore: A po thirrni ju dikë tash në Beograd që përfaqësuesi i BE-së, shefi i delegacionit të BE-së t'ia lejojë delegacionit të Kosovës të marrë pjesë në takim, pas anëtarësimit në organizatë, pa e përmend shtetin ... që neve na kanë nda në partnerë amerikanë apo gjerman, britanezë dhe të tjerë.

Prandaj kur ju e shihni një ... prej meje që është ndoshta nationalist, kur jeni ju në Bengurio në Universitet ai ka të bëjë me mua me real politikë, se do të thotë, kështu duket në praktikë ditore.

Çfarë tha zoti Miletij? Mendoj që është goxha një situatë e re dhe jo se është këtu, dhe unë s'desha që të flas gjatë si politikan, në panel që t'i marrë 10 – 15 minuta vetëm me përshëndetje, por Miletij sa ka qenë në Kuvend të Kosovës ka qenë njëri prej zërave të shpresës. Dhe mendoj çfarë tha ai për një politikë autonome të serbëve në Kosovë, është goxha qenësore dhe në këtë vit dhe vitin e kaluar ne kemi bërë hapa prapa, por shqetësimin e tij që ka për shembull në partitë politike, ka deputetë të cilët nganjëherë kanë shqetësime, paragjykime ose rezerva sikurse ka qenë rasti i Ligjit për Hoqën. Unë mendoj se duhet ta kuptojmë me një kontekst pakëz më të gjerë. Ka një pjesë e njerëzve që janë në politikë, që mendojnë se të drejta të caktuara për komunitetin serb mund a bëjnë disfunksional shtetin e Kosovës. Po jo pse nuk ka vullnet që t'i jepen të drejtat komunitetit serb, dhe duhet ta them kështu goxha më qartë. Do të totë ka të bëjë me atë se sa funksional mund të jetë një ndërtesë politike si shteti i Kosovës.

Por, shqetësimi kryesor, dhe ne e dimë në këtë sallë, është ky. Nuk ka pasur asnjëherë ndonjë rezervë që komuniteti serb të mos ketë të drejta në Kosovë. Unë kam qenë pjesë e negociatave në Vjenë dhe procesi i Vjenës 90% është marrë me të drejtat e serbëve në Kosovë. Por shqetësimi ynë kryesor është që të drejtat e serbëve mund të përkthehen si zgjatje e Serbisë brenda përbrenda territorit të Kosovës. Dhe këtu është ajo çfarë tha edhe zoti Vllasi.

Për deri sa në vitin 2015, 2016 e ke një Serbi e cila synon që fatin e saj politik ta gjejë jashtë kufijve, jo brenda kufijve, që interesi nacional nuk e definojnë qysh e definojnë shtetet normale evropiane për zhvillimin ekonomik, modernizimin, por përsëri territori, përsëri ndërhyrja qoftë në Bosnje, qoftë në Mal të Zi, qoftë në Kosovë, qoftë në Maqedoni atëherë kjo e hap dilemën se çka nënkupto edhe asociacioni, çka nënkuptojnë edhe të drejtat e komunitetit serb në raport me Kosovën. Përndryshe prej anës tonë nuk ka ndonjë shqetësim se cili duhet të jetë niveli i të drejtave serbe brendapërbrenda një Kosove të pavarur. Por të drejtat e serbëve në një raport me një Serbi e cila nuk e ka ndryshuar qëndrimin sa i takon Kosovë, për neve paraqesin shqetësim.

T pajtimi. Në pajtohem plotësisht me atë se çfarë tha profesor Puhovski. Por duhet ta bëjmë një dallim, për mendimin tim. Ne s'po flasim për përgjegjësi penale, po flasim për përgjegjësi politike. Politikisht kurrkush nuk ka përgjegjësi edhe morale. Politikisht kurrkush nuk ka përgjegjësi pse ne kemi luftuar, kemi bërë përpjekje në këto 20 vitet e fundit të jemi të barabartë

me të tjerët. Penalisht, është çështje tjetër, kështu që ajo se çfarë unë shoh në këto debate tona akademike, të shoqërisë civile, të mediave nganjëherë, është një lloj barazimi. Unë mendoj që nuk është mirë që ta promovojmë shumë, politikisht po flas, se ku e çka fillon, që në fund të konfliktit krejt dalin të barabartë, absolut jo. Burim i asaj çfarë ka ndodhur në Kosovë, ka qenë Beogradi. Burim i konfliktit në Kosovë nuk janë raportet serbo-shqiptare brendapërbrenda territorit, janë raportet shqiptarët e Kosovës me Serbinë dhe për mendimin tim nuk ka pajtim çfarëdo që bëjmë ne në Kosovë në raportet shqiptare-serb, për pa pasur një ndryshim radikal të politikës së Beogradit në raport me Kosovën. Nëse nuk kalohet një politikë e cila ndërtohet mbi një konstrukt të racizmit, ku edhe një debat tonin normal kolegë të caktuar mund ta shohin si veç promovim i diçkahit moderne, por jo pse ne mendojmë të sillemi kështu, mua më ka ndodhë vet.

Kur kam qenë vitin e kaluar në Beograd, kanë menduar që unë kam shkuar në Beograd dhe do ta përdori këtë gjuhë pse jam ministër i jashtëm, thashë po na kështu debatojmë në Kosovë. Shihni deklaratat e presidentes, të kryeministrit. Ky është qëndrimi ynë, kjo është Kosova. Ata nuk e njohin realisht se çfarë është në thelb Kosova.

Një shqetësim timin të fundit që e kam për pajtim, por këtu nuk kemi shumë kolegë nga Bashkimi Evropian, është qasja ambiguitive e BE-së. Nëse BE sillet me qasjen dhe me një koncept të ambiguitetit në raport me Kosovën, Parlamenti Evropian e njëj Kosovën por Komisioni Evropian nuk e njëj Kosovën, ose e trajton në mënyrë ambiguitive, unë nuk mendoj se kjo i shërben edhe konceptit të pajtimit. Kështu që, parakushtet për pajtim i kemi të paqarta, politikat janë pa të definuara mirë dhe me thënë të drejtën në 5 vitet e ardhshme, nuk pres ndonjë kthesë të madhe edhe pas anëtarësimit të disa vendeve të rajonit në BE, nuk pres ndonjë ndryshim të madh radikal, vetëm nëse ndryshimi është aq i thellë sa që në fund të procesit ... evropian të mirëfilltë dhe e kemi tejkaluar të kaluarën.

Po çfarë tha zoti Miletiq, unë mendoj se do të ketë ndikim goxha të madh në procesin e pajtimit në të ardhmen nëse serbët e Kosovës nuk kanë lidhësi i cili mendon me kokën e tyre, me interesat e tyre në Kosovë, por janë instrument, që e përmendi edhe zoti Vllasi, janë instrument e politikës së Beogradit, atëherë në dy vitet e fundit janë lëvizë edhe në drejtim të gabuar. Në Graçanicë ju e keni kryetarin e komunës i cili punon me ligje të Kosovës, është betuar me Kushtetutë të Kosovës, nënkryetari i tij, është kryetari i komunës serbe paralele, kështu që kjo tregon se çfarë ndodhë 5 kilometra ngat Prishtinës në procesin e pajtimit.

Bekim Blakaj: Faleminderit shumë, profesor Hoxhaj! Bella!

Xhylbehare (Bella) Murati: Faleminderit Bekim! Unë e pashë këtu që pak u prek ajo ana juridike që ndërlihet me pajtimin. Vetëm desha këtu të them se ne në raport me hulumtimin e ... tranzicionale dhe e shoh atë si një themel që ndërton, vërtetë si themel për një pajtim eventual që mund të ndodhë në të ardhmen.

Sa ua merr mendja juve, sa kanë qenë të suksesshme këto mekanizmat e drejtësisë tranzicionale në Kosovë, që në njëfarë mënyre mund të na sjellin dhe mund të na vetëdijësojnë për të kaluarën tonë, sepse dikush e përmendi që edhe ato shkelje që kanë ndodhur në të kaluarën, në luftën e parë, të dytën... dhe unë mund të them që ato kurrë nuk janë trajtuar ashtu si duhet të trajtohen, prandaj sot jemi ku jemi, sepse ne nëse i mbyllim sytë dhe vetëm themi ... kapemi për hir të një

gjëje, po pajtohemi, e nuk e trajtojmë të kaluarën ashtu siç duhet, kam hallin se në të ardhmen do të na përsëriten gjërat, sikur që na u kanë përsëritur. Prandaj, them që me drejtësinë tranzicionale që për mendimin tim është zbatuar në mënyrë selektive, për atë restorative them se nuk kemi prekur asgjë, përpos këtu shoh se nuk kam qenë në Kosovë një kohë të gjatë mirëpo prej afërt i kam përcjellur gjërat, shoh se këtu na sillen një multikulturalizëm, një koncept që për mua ngjason me “bratstvo jedinstvon” në kohën e kaluar, se sa është diçka që është shumë, së të them, thikë dhe nuk e di që mund ta perceptojmë ne si shoqëri çdo ditë që na vjen prej larti, nuk absorbohet në shoqëri pa ardhur prej rrënjëve. Faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit Bella për pyetjen.

Azem Vllasi: Ju kuptova mirë për e drejta tranzicionale sa ndikon në procesin e pajtimit. Këtë e kemi temë sot dhe këtu kështu ishte pyetja e juaj.

Procesi i pajtimit para se gjithash dhe mbi të gjithash i ka këto aspekte për të cilat folëm edhe këtu, një realitet politik, një trashëgimi që na i kanë lënë konfliktet, e ne duhet të pajtohemi ndërmjet veti se kemi qenë në involvuar në konflikt. Dikush, sikur ne shqiptarët apo boshnjakët, por si viktimë, dikush si agresor. Tashi e kemi raportin vetëm agresori, shkaktuesi i konflikteve, shkaktuesi i krejt asaj për çka ne tash duhet të pajtohemi, qëndron në pozicione të njëjta prej të cilave janë nisur konfliktet të cilat i kanë çrregulluar marrëdhëniet e sot duhet të flasim për pajtim.

Kur të ndryshojnë raportet në këtë rrafsh, në këto binare, si të them, dhe unë mendoj para se gjithash kur të stabilizohet Kosova si shtet që Serbia të flet çka të dojë, e dihet se Kosova është shtet, a bëjmë ne zajednica a çka bëjmë përbrenda, secilit qytetar ia sigurojmë të drejtat e plota, barazinë e plotë qoftë të jetë serb, qoftë të jetë shqiptar, kushdo që të jetë, por jo të përzihet një tjetër shtet e sidomos jo Serbia në ato punë. Dhe kur të bëhet Bosnja sado kudo një shtet funksional, që nuk mund nga pozicioni i entitetit serb me përkrahje prej Beogradi apo prej Moske përditë t’i kërcënohet Bosnjes se do të shkëputën nga Bosnja dhe disa aspekte tjera, atëherë mund të flasim se cilin rol e kanë mekanizmat juridikë, ligji, e drejta tranzicionale e shumë e shumë sende, dhe kur të vijmë në situatë, prapë po i kthehem raportit të Kosovës me Serbinë.

Deri sa të mos mbërrijmë në situatë që ne si shtet, me Serbinë si shtet të bëjmë marrëveshje reciproke, të nënshkruajmë marrëveshje reciproke, për lëmi të ndryshme qysh edhe nënshkruajmë shtetet ndërmjet veti, kjo quhet improvizim, aktrim i normalizimit të raporteve.

A e keni pa ju qysh nënshkruajmë kryeministrat në Bruksel, si i nënshkruajmë marrëveshjet? Nuk ulen qysh nënshkruhen marrëveshjet ndërmjetësuesit ndërmjet tyre, por lakohen pranë një tavoline e ua qesin kështu... A është kështu? Dhe i nënshkruajnë. Pse? Sepse me u ulë Serbia s’po pranon se po thotë po i bie që po ulemi me të vërtetë me kryeministrin e një shteti që është Kosova, e Kosova nuk është shtet.

Tash mos të hyjmë andej, se këtu nuk e kemi temën...

Xhylbehare (Bella) Murati: ... definitivisht dhe unë po e shoh se jeni shumë më politikan se jurist. A bën ... nuk është me afër që numri i atyre që janë ndëshkuar, domethënë kryerësit e veprave penale, a mjafton që në njëfarë mënyre të vetëdijesohen që për të kaluarën çfarë ka ndodhë këtu. Nëse e sheh ti një gjë të tillë, e di që për shembull na s'duhet ta kemi atë ndjenjen që të turpërohemi prej atyre që ndoshta i kemi konsideruar si hero. Dhe unë po dua të di, vetëm në atë mënyrë se ... krimin dikush e ka kry.

Azem Vllasi: Po unë desha të them se cili është dimensiononi në numër dhe hajde të kthehemi edhe aty. Nuk është i mjaftueshëm edhe bindja ime është, nga përvoja nëpër botë që ka pas, kurrë nuk do të ndëshkohen të gjithë ata, bile bile, mos të shprehem me përqindje, e atyre që kanë bërë krime. Por nëse ndëshkohen kryesorët, ajo e ka peshën e vet shumë domethënëse, e nëse gjenden dikush atje se e ka maltretuar dikë, unë s'po them që duhet të anashkalohet drejtësia për këdo që ka prova, por nëse për shembull nga Serbia janë akuzuar, do janë dënuar, do s'kanë mbërri të dënohen, njerëzit kryesorë prej Millosheviqit gjeneralë e tjerë, mund të thuhet – OK, po shihet që kryesorët i janë nënshtruar procedurës penale. OK, ama sa njerëz përbrenda forcave serbe që i ka komanduar ky Llazereviqi që e pritën si hero, i ka marrë 14 vjet burg, e sa kanë kryer ata, i kanë dënuar, janë dënuar në Hagë disa nga kryesorët, e në Serbi vetëm kështu si ekzemplar që me thënë edhe Serbia po i gjykon rastet, cili është marrë, një rast i Podujevës, një rast i Qyshkut të Peja, një rast i Suharekës dhe s'po hyjmë në xhy nah ndaj drejtësisë së Serbisë, ndoshta edhe diçka ka, por ato janë kështu. Drejtësia tranzicionale më shumë mund ta kryejë rolin e vet, si të them, si parim është i gatshëm shteti që t'i dënojë ata që kanë kryer krime, por sa do të arrijë, ajo kurrë nuk do t'ia arrijë as gjysmën, as më pak se gjysmën, as s'ka të drejtë selektive, por nëse kapën kryesorët atëherë mund të thuhet se megjithatë drejtësia ka funksionuar.

Bekim Blakaj: Ju faleminderit zotëri Vllasi. Mendoj që edhe një herë zoti Puhovski të marrë fjalën.

Žarko Puhovski:... as shtetësia e Kosovës sido që të interpretohet bashkësia. Sepse në demokraci është parlamenti... Nëse parlamenti nuk funksionon nga cilat do arsye dhe në këtë mënyrë brutale, atëherë demokracia në të vërtetë nuk funksionon. Dhe unë nuk jam për asnjërin nga këto shtete post Jugosllave nëse nuk janë demokratike. Unë kam qenë për to për shkak që Jugosllavia nuk ka qenë demokratike. Nëse nuk mund të jenë demokratike unë jam kundër cilësdo prej tyre.

Kjo më duket se është demokracia. Nëse nuk e shoh këtë, atëherë mbesim të burgosurit e atij tipi të homogjenizmit për të cilin fola në fillim nga i cili shkohet në konflikte të reja. Ju lutem, më kuptoni se unë me të vërtetë flas si mik nga pozita e dikujt nga jashtë, pak nga brenda, në përgjithësi nga jashtë, si dikush që lexon shtypin e huaj, të cilat flasin për këtë nga lartësia. Ata janë bashkëpërgjegjës, sikurse u tha pak më parë prej kolegëve, ashtu që Bashkimi Evropian në mënyra shumë të çuditshme intervenon, dhe këtë e bën ngadalë.

Çka kanë bërë amerikanët, ... dhe pastaj janë tërhequr pak e kështu me radhë. Këto janë çështje që ne i dimë mirë. Dhe kjo do ndodhë edhe në të ardhmen. Nuk mundemi që të mbështetemi në ta që gjërat të ndreqen. Amerikanët janë me neve... këto tregime mund të zgjasin gjashtë javë, deri sa iu përgjigjet dhe mund të zhduken. Këtë e kemi kaluar të gjithë në vendet post Jugosllave.

Merreni shembullin më të mirë apo më të keq të Maqedonisë. Atë që një shtet mundet ti përcaktoj shtetit tjetër se si do të quhet. Kjo thjeshtë është pafytyrësi pa asnjë paralele. Por kjo kalon që 20 vite, nacionalizmi më i keq në Ballkan sigurisht është, por ata janë në Bashkimin Evropian dhe atyre i tolerohet. Kur unë atë do ta njoh me emrin John Smith, sepse emër tjetër nuk më pëlqen. .. Por kjo është vendosur si pari, ajo është pranuar si parim dhe vetëm një çështje ta përmirësoj, i sigurtë jam që së paku 10 vitet e ardhshme askush nga kjo pjesë e botës nuk do hyjë në Bashkimin Evropian. Pra, ai është proces, dhe pastaj i pari do futet Mali i Zi. Pra, ndoshta është më mirë, kjo është pyetje tjetër, por a do të ketë atëherë Bashkim Evropian, kjo është një pyetje e radhës. Por këto janë gjëra për të cilat duhet të flasim realisht.

Këtë që Serbët ... dy kapitujt e parë, ky është fillimi i debatit, me një shtesë tjetër të cilën politikanët e Juaj do ta paraqesin rrejshëm. Nuk ka negociata për hyrje në Bashkim Evropian. Ato janë negociata të tilla sikurse studentët vijnë në ... nga Zagrebi, Prishtina, Beogradi në Bruksel në provim dhe ata ju pyesin, a ke mësuar, nuk ke mësuar, kthehu në shtëpi dhe mëso e pastaj kthehu prapë në provim. Kjo ashtu duket, nëse diçka...

Këto politikanët i quajnë negociata, ndërsa objektivisht edhe nuk duhet të jenë negociata. Ju duhet që të më demonstroi që jeni të gatshëm të vini në klubin tim. Ky është fakt. Dhe pasta vije, fjalja e fundit, në vazhdim të asaj që tha Azem Vlasi, është e nevojshme ajo që ne e quajmë qasje marksiste, e Gruc Marksit, jo e Karl Marksit, siç ka thënë Marksi kurrë nuk do kisha dashur të jem anëtarë i klubit i cili do më kishte pranuar si anëtar. Dhe kjo secilit prej neve na rri mbi kokë.

Bekim Blakaj: Ju faleminderit shumë profesor Puhovski. Nuk e di nëse dikush ka ndonjë pyetje krejt shkurt, sepse ne kohën e kemi tejkaluar, por nëse dëshiron ndokush të marrë fjalën, le të urdhërojë.

Nexhat Ismajli: Jam Nexhat Ismajli nga OJQ - Aksioni kundër dhunës, pajtimi i paqes... E kam një pyetje për profesor Zharko Puhovskin, të nderuar. Nuk e di se ballafaqimi me të kaluarën në Kroaci a është përfunduar apo ende zgjatë? Faleminderit!

Bekim Blakaj: Faleminderit zotëri Ismajli për pyetjen! Profesor Puhovski!

Žarko Puhovski: Përgjigja e shkurtër do ishte: ky proces nuk ka përfunduar, nuk është duke vazhduar, ndoshta as nuk ka filluar. Kjo është pak e tepruar, por jo krejt e tepruar, thjeshtë sepse ne duke ikur nga ballafaqimi me të kaluarën kemi kaluar në atë që objektivisht e kaluara është harruar; se po vijnë gjenerata të reja të cilëve thjeshtë kjo çështje nuk është fare me rëndësi. Por mbetet ndonjë nishan i vjetër. Të themi që vetëm para katër-pesë vitesh në autostradë për Beograd është shënuar shenja “Beograd”. Para disa vitesh, kur nuk ka pasur GPS kemi pa qindra familje Gjermane që i hapnin hartat sepse gjithandej shkruante “Lipovac”- i cili është një vend i vogël në autostradë për të cilin askush nuk e di se ku gjendet, as në Kroaci. Pesë kilometra pas daljes nga Dubrovniku është kthesa për Trebinje, aty dhjetë herë kanë vendosur tabelën në të cilën shkruan Trebinje, dhe secilën herë gjatë natës e kanë rrëzuar, kështu që ende shkruan Gornji Brgat, fshat i vogël në kufi me Republikën Serbe.

Dubrovnikasit shpesh shkojnë në Trebinje, dhe e dinë se ku është Trebinja, sepse atje blejnë gjëra 20 % më lirë, por të huajt nuk dinë se si shkohet në Trebinje. Nga Trebinja me të vërtetë, me vite, në mënyrë të pashpirt është goditur Dubrovniku. Ato kanë qenë aksione kriminale (në shumicën e rasteve) kundër popullatës civile. Kjo mbetet gjithnjë e më shumë si traumë e pavetëdijshme, por arsyeja e vërtetë në përgjithësi zhduket nga mendja, kështu që animoziteti bartet në simbole, kështu që, në vend të ballafaqimit me të, e kaluara thjeshtë kapërcehet. Problemin e tregon mirë fjalia gjeniale e Homerit të vjetër dhe të verbër e cila thotë: "është gabim të mendojmë se e ardhmja është para nesh dhe e kaluara pas nesh, sepse ne e shohim të kaluarën, pra ajo është para nesh dhe nuk e shohim të ardhmen, prandaj është pas nesh". Duke marrë parasysh që po shkojmë drejt të ardhmes në fakt ne lëvizim mbrapa, kjo është mënyra e vetme është që të orientohemi në këtë, të shikojmë të kaluarën. Kjo është domethënia e gjithë asaj që bëjmë. Sepse, kur humbet njohja e së kaluarën, humbet orientimi. Dhe jo për atë që të dimë çka na keni bërë "ju" "neve" dikur, dhe "ne" "juve", por që të shohim se çka mund të mësojmë nga historia. I përmenduri Hegel në pyetjen se çka mundet të mësohet nga historia, thjeshtë është përgjigjur "Asgjë"! Sepse gjithmonë gjërat e njëjta të pakuptimta përsëriten dhe njerëzit asgjë nuk mësojnë nga e kaluara. Nga kjo gjërat përsëriten, gjë që është keq sepse nuk ballafaqohemi me të kaluarën. Për shembull, Kroacia jeton në besimin triumfal se ka fituar në luftë, dhe kjo është e vërtetë, sikurse që edhe Kosova ka fituar në luftë, por ai që ka fituar nuk ka të drejtë vetëm me faktin se ka fituar. Dhe kjo është ajo që duhet të del në publik në fund të përpjekjeve tona, çështjet e moralit nuk zgjidhmë me fitimin e luftës. Në Kroaci shumë, shumë vështirë depërton në publikun e gjerë, e për fat të keq nuk kam shumë arsye të besoj që edhe në Kosovë do shkojë më mirë.

Bekim Blakaj: Ju faleminderit shumë, profesor Puhovski! Nëse dikush prej panelistëve do të bëjë ndonjë vërejtje përfundimtare, e nëse jo, atëherë dua të ju falënderoj të gjithë juve për pjesëmarrje në këtë debat, panelistët gjithashtu, profesor Puhovski, profesor Hoxhaj, zotëri Vllasi, Miletiq dhe zotëri Arifaj dhe ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje në këtë debat dhe shpresoj që gjatë vitit të ardhshëm do të kemi debate të ngjashme, por me tema të ndryshme. Ju faleminderit edhe një herë dhe ju ftoj për nga një kafe. Faleminderit!